

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatorin Ekonomik: Construmax shpk, Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh, Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	13.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **09.06.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Construmax shpk** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Construmax shpk** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **22.05.2023**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Construmax shpk** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **22.05.2023**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **09.06.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

Përgjigjeje ndaj pretendimit ankimor me Nr. 1

Pretendimi ankimor me Nr. 1 nuk qëndron, ngase Autoriteti Kontraktues ka vepruar plotësisht konform nenit 68 të LPP-ës dhe nenit 8.5 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik të cilët lejojnë Autoritetin kontraktues të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrajnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare

Në përcaktimin e qarkullimit minimal, autoritetet kontraktuese nuk ka kaluar dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesa për qarkullim gjithashtu i referohet maksimum **tri viteve të fundit financiare**. Pra duke pasur parasysh objektin e Kontratës (lëndën e kontratës dhe rendësin e saj) Autoriteti Kontraktues qëndron prapa kërkesës së lartë përmendur.

Gjithashtu përcaktimi në Njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit sa i përket kërkesës se, lideri i grupit duhet të ketë 51% të qarkullimit gjithashtu është minimumi i kërkesës se parapar me nenin **8.5** të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik.

Përgjigjeje ndaj pretendimit ankimor me Nr. 2

Sa i përket Pretendimeve ankimore me Nr.2 gjegjësisht Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pikat 2.1 dhe 2.2, Autoriteti Kontraktues **sipas opinionit të KRPP-ës** ka bërë korrigjimet e duhura me formularin standard B58 (ju lutem shikoni formularin B58 të publikuar me datë: 23.05.2023, për këtë Aktivitet të Prokurimit).

Ndërsa sa i përket pikave 2.5, 2.6 dhe 2.7. Autoriteti Kontraktues sipas informatave që posedon, në lëmit e kërkuar për Inxhinierët e kërkuar në pikat e lartpërmendura nuk ka mungesë të këtyre lëmive me një fjalë përcaktimi i inxhinierëve të lëmive: **Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master – Drejtimi Termoenergjetik, Inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë ose Master, dhe Master ne Menaxhimin e Emergjencave, nuk ulin në asnjë mënyrë Konkurrencën dhe janë kërkesa që i përkasin lëndës së natyrës së Projektit në fjalë.** Të njëjtat gjithashtu nuk janë Kontestuar me Opinionin e KRPP-ës, sipas të cilit ka vepruar Autoriteti Kontraktues sa i përket pikave 2.1 dhe 2.2, të përmendura më lartë.

Me gjithat sa i përket pikës 2.7 Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se pretendimi ankimor për kërkesën që personi me titull Master në Menaxhimin e Emergjencave – përkatësisht “që i njëjti duhet te jetë i certifikuar në lëmin mbrojtje nga zjarri”, është pjesërisht i bazuar me që rast AK do të bëjë korrigjimin e kërkesës në fjalë, pra kërkesa që personi me titull Master në Menaxhimin e Emergjencave “te jetë i certifikuar ne lëmin mbrojtja nga zjarri” do të tërhiqet nga Njoftimi për Kontratë dhe nga Dosja e Tenderit dhe AK do ta bëjë zgjatjen e afatit Kohor për pranim të Ofertave në bazë të nenit 53 të LPP-ës;

Pretendimi ankimor për Pikën 3.1 te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale gjithashtu nuk qëndron ngase përcaktimi i kësaj kërkesë i përket lëndës së natyrës së Projektit në fjalë, dhe kërkesa që **Salduesi te jetë i Certifikuar me ISO nuk kufizon (ashtu siç ju pretendoni) në asnjë mënyrë Konkurrencën.** Për tu certifikuar si saldues sipas Standartit EN ISO 1906-1, nuk është ndonjë procedurë e ndërlikuar dhe nuk ka kosto të lartë, personi i cili dëshiron të certifikohet me një certifikatë të tillë thjesht, paraprakisht duhet të mbajë një trajnim dhe ti nënshtrohet testimit nga ndonjë Kompani e Akredituar për këto ISO, po ashtu vlen të ceket se në tenderin e shpallur nga Komuna e

Rahovecit, me titull: **Renovimi i objektit të vjetër të QKMF - së në Rahovec**, ku ka qenë e parashtruar e njëjta Kërkesë “*Saldues te Certifikuar me ISO*”, keni aplikuar edhe ju si Operator Ekonomik.

Pretendimi ankimor për Pikën 5. te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale gjithashtu nuk qëndron ngase përcaktimi i kësaj kërkesë me ISO WD 28841-2023 (Certifikata për Vlerësimin e thjeshtuar sizmik dhe rehabilitimin e ndërtesave prej betoni), është kërkesë që ka të bëjë lëndën së natyrës së Projektit në fjalë, dhe gjithashtu një kërkesë e tillë është e domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit (Ndërtimin e Objektit) në fjalë.

Pretendimi ankimor për Pikën 6. te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale gjithashtu nuk qëndron. Për ne si Autoriteti Kontraktues, noterizimi i kësaj marrëveshje është i nevojshëm ngase siguron Autoritetin Kontraktues se marrëveshja e tillë e notorizuar obligon palët të kryejna obligimet dhe detyrimet e tyre sipas marrëveshjes se notorizuar dhe mos zbatimi i saj ngërthen në vete pasoja juridike. Me një fjalë një kërkesë e tillë e vendosur në DT ka për qëllim të posedimit të një sigurie për Autoritetin Kontraktues në mbarëvajtjen e punëve që do të ekzekutohen gjatë implementimit të Kontratës, duke pasur parasysh rendësin e aktivitetit të prokurimit dhe vlerën e lart të këtij aktiviteti dhe e njëjta nuk krijon shpenzime të panevojshme dhe të paarsyeshme siç ju pretendoni.

Po ashtu sa i përket pretendimit ankimor për Pikën 7. te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale gjithashtu nuk qëndron. Për ne si Autoriteti Kontraktues, për veç qëllimit të mirë për komunën dhe qytetarët e saj me realizimin e këtij projekti, rëndësi të veçante ka edhe mënyra e implementimit të tij, siç është siguria dhe shëndeti i punonjësve në punë. **Siguria dhe shëndeti në punë parashihet edhe me Ligjet tjera në fuqi në Republikën e Kosovës, si p.sh. Ligji për Ndërtim.** Kërkesa e vendosur në DT që Njëzetë (20) punëtor të jenë të trajnuar dhe certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, për veç që është kusht social gjithashtu është edhe në harmoni me Ligjet tjera në fuqi në Republikën e Kosovës dhe si rrjedhojë AK qëndron pran një kërkesë të tillë dhe pretendimin tuaj ankimor e hedh poshtë si të pa bazuar.

Sa i përket Pretendimeve ankimore me Nr. 8 të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Autoriteti Kontraktues sipas opinionit të KRPP-ës ka bërë korrigjimet e duhura (ju lutem shikoni formularin B58 të publikuar me datë: 25.05.2023, për këtë Aktivitet të Prokurimit).

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmime është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim.** Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në pajtueshmëri me objektin e kontratës. **Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave dhe dëshmime mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik ku ka kërkuar kualifikimet shkollore Stafin profesional (inxhinierët) e domosdoshëm për implementimin e këtij projekti si dhe **punëtoret (stafin teknik)** të domosdoshëm për implementim të këtij projekti.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit